

**DREJTUAR:**

**KËSHILLIT MËSIMOR - SHKENCOR TË FAKULTETIT EKONOMIK**

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES**

*Për zgjedhjen - rizgjedhjen e mësimdhënësit në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në leminë Financa (50326 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).*

Në bazë të nenit 1 të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr.114-373/8 të datës 14.06.2022 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit Ekonomik në përbërje:

- 1. Prof. dr. Etem Iseni (kryetar)- profesor i rregullt në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës;**
- 2. Doc.dr. Lindita Muaremi (anëtar)- docent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës;**
- 3. Doc.dr. Sindize Salihi (anëtar)- docent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës;**

në lidhje me Konkursin për zgjedhje - rizgjedhje të shpallur me datën 20.05.2022 në gazetën “Koha”, “Слободен печат” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës ([www.unite.edu.mk/konkurse](http://www.unite.edu.mk/konkurse)) për zgjedhje - rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore - shkencore për lëndët: *Financa*, komisioni recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim, konstatoi se:

**Dr. Ali Maksuti**, i lindur më **20.05.1986**, në Tetovë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me numër aplikimi **04-05/14** të datës **26.05.2022**.

Komisioni recensues, pasi e kontrollon materialin e konkursit, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë përshkrim:

## R E F E R A T

### **Të dhënat biografike, përgatitja profesionale-shkencore dhe aktiviteti pedagogjik**

Kandidati **Dr. Ali Maksuti**, është i lindur në Tetovë më 29 Maj 1986. Arsimin fillor e kreu në shkollën fillore “Naim Frashëri” kurse të mesmen në shkollën e mesme ekonomike në Tetovë, 8 Shtatori. Studimet diplomike i ka kryer në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti Ekonomik në vitin 2008, në drejtimin Kontabilitet dhe financa. Studimet pasdiplomike i ka kryer në Universitetin në Hamburg vitin 2012 me temë *“Krizat financiare dhe efektet e saj në institucionet financiare të Bashkimit Europian”*. Studimet e doktoraturës i kreu në Universitetin në Hamburg, më 25.05.2016 me temë disertacioni *Krizat financiare dhe efektet e saj në Ballkanin Perëndimorë*.

Ka marrë pjesë në konferenca shkencore, në seminare dhe trajnime profesionale, gjithashtu ka qenë i angazhuar edhe në përgatitjen e kuadrove profesional për financa dhe kontabilitet në edukimin joformal.

Njihet gjuhën: shqipe, maqedonase, angleze në nivel të përgatitjeve të hulumtimeve shkencore, kurse gjuhën gjermane në nivel komunikimi. Është i angazhuar si mësimdhënës në arsimin e lartë si asistent - part-time në Universitetin e Tetovës.

### **VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

#### **Lëndët të cilat mësimdhënësi i ka zhvilluar në ciklin e parë:**

- Bazat e kontabilitetit/ Ligjërues dhe asistent
- Financat ndërkombëtare / Asistent
- Menaxhimi organizativ / Ligjërues dhe asistent
- Kontabiliteti financiar/ Asistent

- Mikroekonomi / Asistent
- Ekonomia dhe zhvillimi ekonomisë nacionale / Ligjerues dhe asistent
- Praktika profesionale / Ligjerues dhe asistent

## **VEPRIMTARIA SHKENCORE- HULUMTUESE**

### **Punime të botuara në revista shkencore ndërkombëtare:**

- **Ali Maksuti**, *Copmarasion of financial crises with the financial crises of period of 2008-2010, Uni Hamburg, CIS, UniHamburg, 2011*
- **Ali Maksuti**, *Use of total quality management (TQM )in sector of financial services of the banking sector in North Macedonia, NOWY STAW Fondation conference, 2011, UDF 2-434-1*
- **Ali Maksuti**, *Financial innovation , the global market without limits, Economic Vision, 2019*
- **Ali Maksuti**, *Empirical Analysis of Value Added Tax and Inflation Rate:Tukey Hsd Test in Selected Western Balkan Countries , Tekirdağ Namık Kemal University Faculty of Economics and Administrative Sciences International Symposium on Public Finance Tekirdağ, 2020*
- **Ali Maksuti**, *Fixed exchange rate and foreign exchange intervention case of North Macedonia period from 1997 to 2017 , Academic Journal of Digital Economics and Stability, vol.17, May 2022*
- **Ali Maksuti**, *Macroeconomic determinants of foreign direct investment in North Macedonia- empirical analysis, Economic Vision, 2021*
- **Ali Maksuti**, *Women Entrepreneurship in Small and Medium Enterprises in North Macedonia, INTERNATIONAL JOURNAL ON ECONOMICS, FINANCE AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT, vol.14, 2022*
- **Ali Maksuti**, *The significance of accounting information and the effects on shareholder companies, case of North Macedonia 1995-2020, Economic Vision, in process for 2022.*

### **Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare:**

1. Future investment and financial innovation , Uni Hamburg, Germany 2012
2. 7<sup>th</sup> International scientific conference “ Contemporary economic trends “ CET 2019, University of Tetovo
3. 3<sup>rd</sup> International Multidisciplinary Scientific Video Conference IMSC – 2020 - Institute of English Language and American Studies – Tetovo.
4. 15<sup>th</sup> Economic forum of young leaders “ Building civil society , solidarity and international partnership “ 08-10 September 2020.
5. 15<sup>th</sup> Economic forum of young leaders – European Meeting Center – Nowy Staw foundation
6. Tekirdağ Namık Kemal University Faculty of Economics and Administrative Sciences International Symposium on Public Finance Tekirdağ/TURKEY May 24-25, 2021  
“Empirical Analysis of Value Added Tax and Inflation Rate:Tukey Hsd Test in Selected Western Balkan Countries “
7. Annual International Conference, Economies of the Balkan and Eastern European Countries- EBEEC 2021. - International Hellenic University , - Topic - “Empirical analysis of real money demand determinants and stability in case of North Macedonia”
8. Annual International Conference , Economies of the Balkan and Eastern European Countries – EBEEC 2021 - International Hellenic University , - Topic “Fixed exchange rate and foreign exchange intervention case of North Macedonia period from 1997 to 2017”
9. 2021 International Summer School, Ss. Cyril and Methodius" University in Skopje topic “LEARN HOW TO EVALUATE THE ECONOMIC IMPACT OF THE COVID-19 PANDEMIC “

### **Punime shkencore të recenzuara nga kandidati**

1. Time-Varying Trend Inflation, Financial Constraints and Policy Uncertainty, Horizon Research Publishing, USA, 06.02.2022
2. Fiscal efficiency and modeling of excise tax payment , Horizon Research Publishing, USA, 17.03.2022
3. Taxing the Digital Economy through Consumption Taxes (VAT) in African Countries: Possibilities, Constraints, and Implications, Horizon Research Publishing, USA, 18.04.2022

### **Libra të recenzuara nga kandidati:**

1. Комплексиум, Куманово, 2020, Рецензент, Али Максuti, botimi përkrahur nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë Veriore,
2. Стратегиското комуницирање на хуманитарните организации, Куманово, 2021, Рецензент, Али Максuti, botimi përkrahur nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë Veriore,

### **PROPOZIM - VENDIM**

Komisioni Recensus, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit-konkurrent, duke u mbështetur në vlerësimet e paraqitura në këtë referat, si dhe duke i marrë për bazë përvojën profesionale të kandidatit, ka nderin që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Ekonomik, t’i propozojë që **Dr. Ali Maksuti** të zgjidhet në thirrjen e titulluar **Docent** në **Financa (50326 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).**

Komsioni recenzues vlerëson se kandidati ka kualitete shkencore dhe profesionale, i plotëson të gjitha kriteret shkencore dhe e profesionale te parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e UT-së, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore dhe thirrje të bashkëpuntorëve, dhe aktet tjera normative, për t’u zgjedhur në këtë thirrje mësimore-shkencore.

Anëtarët e Komisionit recensues:

**Prof.dr. Etem Iseni** (kryetar)

---

**Doc.Dr. Lindita Muaremi** (anëtar)

---

**Doc.dr. Sindize Salihi** (anëtar)

---

Tetovë, 30.06.2022

## SHTOJCË

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,  
MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

**Kandidati:**

Ali Gazi Maksuti

**Institucioni:**

Universiteti Tetovës, Fakulteti Ekonomik

**Fusha shkencore:** *FINANCA*

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR – DOCENT / TITULLIN SHKENCOR – BASHKËPUNËTOR SHKENCOR

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Suksesi mesatar në ciklin e parë: <u>8.76</u> Suksesi mesatar në ciklin e dytë: <u>9.3</u> Suksesi mesatar <u>9.03</u> për studimet e integruara.	Po
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: <u>Ekonomi</u> , fushës <u>Financa</u> , degës <u>Financa dhe kontabilitet</u>	Po
3	Të publikuara së paku katër punime shkencore* në publikim shkencor referent në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje.	Po
3.1	Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime shkencore të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, e cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit të lartë	Po

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	1. Emri i revistës shkencore: <u> Academic Journal of Digital Economics and Stability</u> 2. Emri i bazës elektronike të revistave: <u><a href="https://economics.academicjournal.io/index.php/economics/T">https://economics.academicjournal.io/index.php/economics/T</a></u> 3. Titulli i punimit: <u> Fixed Exchange Rate and Foreign Exchange Intervention Case of North Macedonia Period from 1997 to 2017</u> 4. Data e publikimit: <u> 01.06.2022</u>	
3.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. 1. Emri i revistës shkencore: <u> INTERNATIONAL JOURNAL ON ECONOMICS, FINANCE AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT</u> 2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): <u> 43</u> 3. Titulli i punimit: <u> Women Entrepreneurship in Small and Medium Enterprises in North Macedonia</u> 4. Data e publikimit: <u> 16.06.2022</u>	Po
3.3	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe e cila publikohet në shtetin anëtar i Bashkimit Evropian/ose OBZHE 1. Emri i revistës shkencore: <u> CIS, Journal</u> 2. Emri i anëtarit të BE/OBZHE <u> Germany</u> - Titulli i punimit: <u> , Copmarasion of financial crises with the financial crises of period of 2008-2010,</u> 3. _____ 4. Data e publikimit: <u> 12.03.2011</u>	Po
3.4	Përbledhja e punimeve shkencore të recensuara, të prezantuar në tubime shkencore ndërkombëtare, ku anëtarët anëtarët e programit ose këshillit shkencor janë nga së paku tre shtete 1. Titulli i përmbledhjes: _____ 2. Emri i tubimit ndërkombëtar: _____ 3. Emrat e shteteve: _____ 4. Titulli i punimit: _____ 5. Data e publikimit: _____	Po

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
3.5	<p>Përkthime të veprave kapitale në fushat të cilat i përcakton Këshilli kombëtar i arsimit të lartë dhe veprimtaria kërkimore-shkencore</p> <p>1. Titulli i veprës kapitale të përkthyer: _____</p> <p>2. Data e publikimit: _____</p> <p>3. Botuesi, vendi dhe viti i botimit: _____</p>	Jo
4	<p>Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur</p> <p>1. Gjuha e huaj: ___Angleze_____</p> <p>2. Emri i dokumentit: ___Certifikate_____</p> <p>3. Dhënësi i dokumentit: ___Vision Academy_____</p> <p>4. Data e dhënies së dokumentit: ___2014_____</p>	Po
5	<p><b>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë ___Universiteti Tetovës_____</p> <p>2. Lloji i trajnimit/ përvoja /arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë _____</p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë ___2020-2022_____</p>	Po

\* Për kandidatin/ët, i cili ka më tepër se 4 (katër) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues punimet shkencore do t'i përmend, do t'i shënojë dhe vlerësojë me pikë në Formularin 2.

**Kandidati:** Ali Maksuti  
**Institucioni:** Fakulteti Ekonomik - UT, Tetovë  
**Lëmia shkencore:** Financa



## VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

1.	Emri i aktivitetit: Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e pare të studimeve)	Pikët 43.78 pikë
1.1	Bazat e kontabilitetit 3+2	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
1.2	Bazat e kontabiliteti, 3+3	$2 \times 15 \times 6 \times 0.04 = 7.2$
1.3	Financa ndërkombëtare 2	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
1.4	Bazat e kontabilitetit 3+2	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
1.5	Menaxhimi organizatës 3+2	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
1.6	Kontabiliteti financiar 3	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
1.7	Mikroekonomi 2	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
1.8	Praktika profesionale 3+2	$2 \times 16 \times 5 \times 0.04 = 6.4$
1.9	Ekonomia dhe zhvillimi ekonomisë nacionale, 2+1	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
1.10	Konsultime Shkurt 2020-Qershor 2022	$94 \times 0.002 = 0.18$

<b>Gjithsej</b>	<b>43.78 pikë</b>
-----------------	-------------------

## VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar</b>	<b>40.00 pikë</b>
1.1	- <i>Copmarasion of financial crises with the financial crises of period of 2008-2010, Uni Hamburg, CIS, UniHamburg, 2011</i>	5
1.2	- <i>Use of total quality management (TQM )in sector of financial services of the banking sector in North Macedonia, NOWY STAW Fondation conference, 2011, UDF 2-434-1</i> -	5
1.3	- <i>Financial innovation , the global market without limits, Economic Vision, 2019</i>	5
1.4	- <i>Macroeconomic determinants of foreign direct investment in North Macedonia-empirical analysis, Economic Vision, 2021</i> -	5
1.5	- <i>Empirical Analysis of Value Added Tax and Inflation Rate:Tukey Hsd Test in Selected Western Balkan Countries , Tekirdağ Namik Kemal University Faculty of Economics and Administrative Sciences International Symposium on Public Finance Tekirdağ, 2020</i>	5
1.6	- <i>Women Entrepreneurship in Small and Medium Enterprises in North Macedonia, INTERNATIONAL JOURNAL ON ECONOMICS, FINANCE AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT, vol.14, 2022</i>	5
1.7	- <i>Fixed exchange rate and foreign exchange intervention case of North Macedonia period from 1997 to 2017 , Academic Journal of Digital Economics and Stability, vol.17, May 2022</i>	5
1.8	- <i>The significance of accounting information and the effects on shareholder companies, case</i>	

	<i>of North Macedonia 1995-2020, Economic Vision, in process for 2022.</i>	5
<b>2</b>	<b>Pesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat-prezentim oral</b>	<b>18.00 pikë</b>
2.1	- Future investment and financial innovation , Uni Hamburg, Germany 2012	2
2.2	7 <sup>th</sup> International scientific conference “ Contemporary economic trends “ CET 2019, University of Tetovo	2
2.3	3 <sup>rd</sup> International Multidisciplinary Scientific Video Conference IMSC – 2020 - Institute of English Language and American Studies – Tetovo.	2
2.4	15 <sup>th</sup> Economic forum of young leaders “ Building civil society , solidarity and international partnership “ 08-10 September 2020.	2
2.5	15 <sup>th</sup> Economic forum of young leaders – European Meeting Center – Nowy Staw foundation	2
2.6	Tekirdağ Namık Kemal University Faculty of Economics and Administrative Sciences International Symposium on Public Finance Tekirdağ/TURKEY May 24-25, 2021	2
2.7	Annual International Conference, Economies of the Balkan and Eastern European Countries-EBEEC 2021. - International Hellenic University	2
2.8	2021 International Summer School, Ss. Cyril and Methodius" University in Skopje topic “LEARN HOW TO EVALUATE THE ECONOMIC IMPACT OF THE COVID-19 PANDEMIC “	2
2.9	9th International Scientific Conference – “Scientific Challenges for Sustainable Development” STRUGA, 03 June, 2022	2
<b>3</b>	<b>Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore-ndërkombëtare</b>	<b>8.00 pikë</b>
1.1	- <i>Copmarasion of financial crises with the financial crises of period of 2008-2010, Uni Hamburg, CIS, UniHamburg, 2011</i>	1
1.2	- <i>Use of total quality management (TQM )in sector of financial services of the banking sector in North Macedonia, NOWY STAW Fondation conference, 2011, UDF 2-434-1</i>	1
1.3	- <i>Financial innovation , the global market without limits, Economic Vision, 2019</i>	1
1.4	- <i>Macroeconomic determinants of foreign direct investment in North Macedonia-empirical analysis, Economic Vision, 2021</i>	1
1.5	- <i>Empirical Analysis of Value Added Tax and Inflation Rate:Tukey Hsd Test in Selected Western Balkan Countries , Tekirdağ Namık Kemal University Faculty of Economics and Administrative Sciences International Symposium on Public Finance Tekirdağ, 2020</i>	1
1.6	- <i>Women Entrepreneurship in Small and Medium Enterprises in North Macedonia, INTERNATIONAL JOURNAL ON ECONOMICS, FINANCE AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT, vol.14, 2022</i>	1
1.7	- <i>Fixed exchange rate and foreign exchange intervention case of North Macedonia period from 1997 to 2017 , Academic Journal of Digital Economics and Stability, vol.17, May 2022</i>	1
1.8	- <i>The significance of accounting information and the effects on shareholder companies, case of North Macedonia 1995-2020, Economic Vision, in process for 2022.</i>	1
<b>4</b>	<b>Çertifikata për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime</b>	<b>6.00</b>

		<b>pikë</b>
4.1	NCBI – National Coalition Building Institute, Certificate	1
4.2	Nansen Dialogue Centre Topic “ International learning for managing with conflicts “ , Certificate	1
4.3	Nansen Dialogue Centre, Topic “ Reduction of prejudice “ , Certificate	1
4.4	International Business Management Institute Berlin, Berlin Germany – Finance and Accounting , 2020 , Certificate	1
4.5	1. 15 <sup>th</sup> Economic forum of young leaders – European Meeting Center – Nowy Staw foundation	1
4.6	15 <sup>th</sup> Economic forum of young leaders “ Building civil society , solidarity and international partnership “ 08-10 September 2020	1
<b>Gjithsej</b>		<b>72.00 pikë</b>

### **VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE**

<b>Nr.</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikët</b>
<b>1</b>	<b>Libër nga lëmia profesionale/recenzim</b>	
1.1	Time-Varying Trend Inflation, Financial Constraints and Policy Uncertainty, Horizon Research Publishing, USA, 06.02.2022	2
1.2	Fiscal efficiency and modeling of excise tax payment , Horizon Research Publishing, USA, 17.03.2022	2
1.3	Taxing the Digital Economy through Consumption Taxes (VAT) in African Countries: Possibilities, Constraints, and Implications, Horizon Research Publishing, USA, 18.04.2022	2
1.4	Dispensë për përdorim të brendshëm nga ligjëratat, Bazat e kontabilitetit, Financa ndërkombëtare dhe Ekonomia Nacionale dhe zhvillimi ekonomik	4
1.5	Комплексиум, Куманово, 2020, Рецензент, Али Максути, botimi përkrahur nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë Veriore,	2
1.6	Стратегиското комуницирање на хуманитарните организации, Куманово, 2021, Рецензент, Али Максути, botimi përkrahur nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë Veriore,	2
<b>Gjithsej</b>		<b>14.00 pikë</b>

**VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikët</b>
<b>1.</b>	<b>Kryeredaktor revistes ekonomike – Ekonomist</b>	<b>2</b>
<b>2.</b>	<b>Anëtarë i bordit të revistet ekonomike – Ekonomia Islame</b>	<b>0.5</b>
<b>3.</b>		
	<b>Gjithsej</b>	<b>2,5</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>43.78</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>72.00</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>14.00</b>
<b>VEPÇRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>2.5</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>132.28 pikë</b>

Anëtarët e Komisionit recensues:

**Prof.dr. Etem Izeni** (kryetar)

\_\_\_\_\_  
**Doc.dr. Lindita Muharemi** (anëtar)

**Doc.dr. Sindize Salihi**

(anëtar)

Tetovë, 30.06. 2022

**Deri te:**

## **KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT EKONOMIK**

### **RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES**

*Për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje të titulluar **DOCENT** në lëminë Financave (5032 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).*

Në bazë të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr.14-379/7 të datës 12.06.2022 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit Ekonomik në përbërje prej:

1. **Prof. Dr. Shiret Elezi (Kryetar)** - profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.
2. **Doc. Dr. Sindis Salihi (anëtar)** – docent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.
3. **Prof. Dr. Teuta Qerimi (anëtar)**- docent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

Në lidhje me konkursin e shpallur në faqen zyrtare të **Universitetit të Tetovës** ([www.unite.edu.mk/konkurse](http://www.unite.edu.mk/konkurse)) si dhe në gazetata ditore “**Koha**” dhe “**Nova Makedonija**” të datës 20.05.2022 për zgjedhjen e Një mësimdhënësi në thirrje të titulluar docent në lëminë Financave (50326 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), u paraqit kandidati **Dr. Fekri Iseni** me numër aplikimi 04/04 të datës 20.05.2022.

### **1. TË DHËNA BIOGRAFIKE TË KANDIDATIT**

Kandidati, **Dr.sc.Fekri Iseni** është i lindur më 08.08.1985 në Tetovë, komuna e Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut, ndërsa me vendbanim në f.Sedllarcë e Epërme, Komuna e Bogovinës. Shkollën fillore e kreu në f.Sedllarcë e Epërme ndërsa të mesmen në shkollën Moshë Pijade në Tetovë. Studimet deridiplomike i mbaroi me sukses të dalluar në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Ekonomik në periudhën 2004-2008 ku fiton titullin **Ekonomist i diplomuar**.

Pas përfundimit të studimeve kandidati Fekri Iseni angazhohet në Universitetin FON në Shkup, fakulteti ekonomik në pozitën e asistentit në lëndët Bazat e Kontabilitetit dhe Kontabiliteti Financiar. Në vitin 2011 kandidati Fekri Iseni përfundon me sukses studimet

e magjistraturës në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës mbron temën e magjistraturës me titull:

**“Metodat e përlllogaritjes së prodhimit në fabrikën për prodhimin e mobiljeve Inter Fantasy Tetovë ”** dhe fiton titullin **Magjistër i Shkencave Ekonomike**. Pas përfundimit të studimeve të magjistraturës kandidati angazhohet në pozitën e asistentit të jashtëm në kolegjin PJETER BUDI në Prishtinë, fakulteti ekonomik në lëndët Bazat e Kontabilitetit, Kontabiliteti Financiar dhe Financat Publike. Po ashtu gjatë viteve 2012-2013 kandidati ka ushtruar profesionin e asistentit mësimor në Universitetin e Tetovës, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara drejtimi Inxhinieri Ekonomike në lëndën Bazat e Kontabilitetit. Në vitin 2021 në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, drejtimi Ekonomiks, mbron me sukses disertacionin e doktoratës me titull:

**“Faktorët e rritjes së kompanive në Republikën e Maqedonisë së Veriut ”** dhe merr titullin Doktor i Shkencave Ekonomike. Disertacioni i doktoratës ka dhënë kontribut të veçantë shkencor për menaxherët dhe pronarët e kompanive si dhe për specialistët të fushës së financave.

Prej vitit akademik 2021/2022 është angazhuar në Universitetin e Tetovës si ligjërues (part-time) në programin studimor Prodhimtari Bimore-Fakulteti Bujqësisë dhe Bioteknologjisë në Universitetin e Tetovës.

## **2. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE – ARSIMORE**

### **Mbajtja e mësimit (ushtrime dhe ligjërata)**

**Ligjerata ne Univesitetin FON –Shkup,viti akademik 2009-2011 ushtrime në lëndët:**

Bazat e Kontabilitetit dhe Kontabiliteti Financiar ;

**Në Universitetin e Tetovës-drejtimi inxhinjeri ekonomike, viti akademik 2012-2013**

ka mbajtur ushtrime në lëndën Bazat e kontabilitetit;

**Në Universitetin Pjeter Budi – Prishtine, viti akademik, 2012-2014, ligjerues në lëndet:**

Bazat e Kontabilitetit, Kontabiliteti Financiar dhe Financa Publike;

**Në Universitetin e Tetovës - Fakulteti Bujqësisë dhe Bioteknologjisë - programi studimor Prodhimtari Bimore** nga viti 2022, ligjërues në lëndën Shpenzimet dhe Kalkulimet .

### 3. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor dhe me biznes privat, kandidati është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore në fushën e financave. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikujt shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe me pjesëmarrje në tubime shkencore në vend dhe jashtë tij. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur më poshtë:

1. Mr. Fekri Iseni, "Small and Medium Enterprises as a Main Pillar for the Economic Development of the Republic of Macedonia with the Function of the Integration of Macedonia in the European Union", Konferenca shkencore ndërkombëtare "Menaxhimi i resurseve ekonomike në funksion të zhvillimit të vendeve në tranzicion" Prishtinë, Maj 2013.
2. Prof.Dr.Seadin Xhaferi, Prof.Dr.Astrit Mehmeti, Mr. Fekri Iseni, "RELATIONSHIP BETWEEN PRICE AND EARNINGS THROUGH DIVIDENT YIELD AND REQUIRED YIELD ABOVE THE EXPECTED INFLATION", 8th Research/Expert Conference with International Participations "Quality 2013" Neum, B & H.
3. Dr.Etem Iseni, Mr. Fekri Iseni, СОВРЕМЕНИ КОНТРОЛНИ СИСТЕМИ КАКО ПРОФЕСИОНАЛНА ПОДДРШКА НА МЕНАЏМЕНТОТ ВО ДОНЕСУВАЊЕ НА ОДЛУКИ, XVI Симпозиум на Сметководители на Р.Македонија, Struga,2014
4. Doc.Dr.Etem Iseni , Mr.Fekri Iseni, "THE CONTEMPORARY TRENDS OF ACCOUNTING INFORMATION SYSTEM" , International Scientific Journal in economics, Finance, Businessm Marketing, Management and Tourism, Tetovo, Vol.1, No 1-2 Tetovo, 2014.
5. Etem Iseni, Fekri Iseni, "THE IMPORTANCE OF FINANCIAL REPORTING AND AUDIT IN THE NEW SOCIO-ECONOMIC CIRCUMSTANCES", International Scientific Journal in economics, Finance, Business Marketing, Management and Tourism, Vol 3, No 5-6, Tetovo, 2016. ISSN (print) 1857-9566.
6. Etem Iseni, Fekri Iseni, " COST-BENEFIT ANALYSIS OF MIGRATION EFFECTS ON THE ECONOMY OF REPUBLIC OF MACEDONIA", 4th International Scientific Conference of the faculties of the economics & Business Administration, University of Tetovo, ISCFE, 2016, Tetovo. ISSN (print) 1857-9566
7. Etem Iseni, Sheherzada Murati, Fekri Iseni, "Tax Policy in small and medium sub-function funds", International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism, Vol.5 No 9-10, pp 37-43, Tetova, 2018. ISSN:2545-4544 (online)
8. Fekri Iseni, "Vendndodhja si faktorë i rritjes së ndërmarrjeve në Maqedoninë e Veriut". Revista shqipëtare social ekonomike, Albanian socioeconomic review. Viti XXVII, nr.1 (104) Janar-Prill 2021. Online ISSN: 2312-5349.
9. Sali Zhaku, Arben Oda, Fekri Iseni, Sheherzada Murati, "Alternative energy as a need for a new world order" International Scientific Journal in Economics, Finance, Business,

Marketing, Management and Tourism (Economic Vision) Vol.9, No 17-18, Year 2022. ISSN (online): 2545-4544, ISSN (print) 1857-9566.

10. Arben Oda, Sali Zhaku, Fekri Iseni, "SWOT analysis in fuction of the development of hotel enterprises in Struga. Revista shqiptare social ekonomike – Albanian socio economic review, viti XXVII, nr.1 (107), Tiranë 2022, faqe 57-66. ISSN (print) 2222-5846, ISSN (online) 2312-5349.

#### **4. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE**

Si shtojcë e referatit është bashkangjitur raporti i zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati **Dr. Sc. Fekri Iseni** ka gjithsej 87.4 pikë, edhe atë për: Veprimtarinë mësimore-arsimore 32.04 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 37.00 pikë, veprimtarinë me interes të gjërë -publikuese 18.00 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	<b>32,04</b>
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	<b>34.00</b>
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË – VEPRIMTARIA PUBLIKUESE	<b>18.00</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>84.04</b>

#### **PROPOZIM - VENDIM**

Në bazë të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe kushteve të kërkuara për zgjedhje- rizgjedhje në thirrje mësimore - shkencore në Fakultetin Ekonomik– Universiteti i Tetovës, Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'i propozojë Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Ekonomik që:

Kandidati **Dr. Sc. Fekri Iseni** të zgjidhet në thirrjen e titulluar mësimore-shkencore **DOCENT** në lëminë Financave (5032 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin Ekonomik në Universitetit e Tetovës.

Tetovë, Korrik 2022

#### **Anëtarët e Komisionit Recensues:**

##### **1. Prof. Dr. Shiret Elezi-kryetar**

Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës



---

**2. Doc. Dr. Sindis Salihi – anëtar**

Docent në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës

---

**3. Doc. Dr. Teuta Qerimi- anëtar**

Docent në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës

---



4.	<p>Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, d.m.th. një shkollë e lartë profesionale e pavarur.</p> <p>Gjuha e huaj: <u>Angleze</u></p> <p>Emri i dokumentit: <u>Çertifikatë</u></p> <p>Publikuesi i dokumentit: Qendra për gjuhë të huaja në Universitetin e Evropës Juglindore Tetovë.</p>	Po
5.	<p><b>Ka aftësi për të kryer veprimtari të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit në të cilin janë fituar aftësitë për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë.</p> <p><b>Universiteti FON-Shkup</b></p> <p><b>Universiteti PJETER BUDI, Prishtinë</b></p> <p><b>Universiteti i Tetovës</b></p> <p>2. Lloji i trajnimit / përvojës / arsimimit për përvetësimin e aftësive për të kryer veprimtari të arsimit të lartë</p> <p><b>Mësimdhënie</b></p> <p>3. Periudha e përvetësimit të aftësive për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë</p> <p><b>2009-2011– Universiteti FON SHKUP</b></p> <p><b>2012-2013 Universiteti i Tetovës,inxhinjeri ekonomike</b></p> <p><b>2012-2014 – Universiteti PJETER BUDI, Prishtinë</b></p> <p><b>2022- Universiteti i Tetovës</b></p>	Po

## FORMULARI 2

### RAPORTI PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE- SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati **Dr. Sc. Fekri Iseni**

Institucioni: **Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës**

Lëmi shkencore: **Financa** (5032 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

#### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikë
<b>1.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave me mbulesë nga profesori bartës i lëndës, në ciklin e parë të studimeve</b>	
1.1.	Bazat e kontabilitetit	$3 \times 15 \times 0.04 \times 4 = 7.2$
1.2.	Kontabilitet Financiar	$3 \times 15 \times 0.04 \times 4 = 7.2$
1.3.	Financa Publike	$2 \times 15 \times 0.04 \times 4 = 4.8$
1.4.	Shpenzimet dhe kalkulimet	$3 \times 15 \times 0.04 \times 1 = 1.8$
<b>2.</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve me studentë</b>	
2.1.	Bazat e kontabilitetit	$2 \times 15 \times 0.03 \times 4 = 3.6$
2.2.	Bazat e kontabilitetit	$2 \times 15 \times 0.03 \times 4 = 3.6$
2.3.	Kontabilitet Financiar	$2 \times 15 \times 0.03 \times 4 = 3.6$
<b>3.</b>	<b>Konsultime me studentë</b>	<b>Pikë</b>
3.1.	Bazat e kontabilitetit	$15 \times 0.002 \times 4$
	Kontabilitet Financiar	$=0.12$ $15 \times 0.002 \times 4$ $=0.12$
	<b>Gjithsej</b>	<b>32.04</b>

**VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

<b>N. R.</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikë</b>
<b>1.</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	
<b>1.1.</b>	Teza e doktoratës mban titullin <i>“Faktorët e rritjes së kompanive në Republikën e Maqedonisë së Veriut”</i> mbrojtur në vitin 2021.	
<b>2.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar</b>	<b>Pikë</b>
<b>2.1.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mr. Fekri Iseni, "Small and Medium Enterprises as a Main Pillar for the Economic Development of the Republic of Macedonia with the Function of the Integration of Macedonia in the European Union", Konferenca shkencore ndërkombëtare “Menaxhimi i resurseve ekonomike në funksion të zhvillimit të vendeve në tranzicion” Prishtinë, Maj 2013.</li> </ul>	<b>5.00</b>
<b>2.2.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prof.Dr.Seadin Xhaferi, Prof.Dr.Astrit Mehmeti, Mr. Fekri Iseni, "RELATIONSHIP BETWEEN PRICE AND EARNINGS THROUGH DIVIDENT YIELD AND REQUIRED YIELD ABOVE THE EXPECTED INFLATION", 8th Research/Expert Conference with International Participations “Quality 2013” Neum, B &amp; H.</li> </ul>	<b>3.00</b>
<b>2.3.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dr.Etem Iseni, Mr. Fekri Iseni, СОВРЕМЕНИ КОНТРОЛНИ СИСТЕМИ КАКО ПРОФЕСИОНАЛНА ПОДДРШКА НА МЕНАЏМЕНТОТ ВО ДОНЕСУВАЊЕ НА ОДЛУКИ, XVI Симпозиум на Сметководители на Р.Македонија, Struga,2014</li> </ul>	<b>3.00</b>
<b>2.4.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Doc.Dr.Etem Iseni , Mr.Fekri Iseni, "THE CONTEMPORARY TRENDS OF ACCOUNTING INFORMATION SYSTEM" , International Scientific Journal in economics, Finance, Businessm Marketing, Management and Tourism, Tetovo, Vol.1, No 1-2 Tetovo, 2014.</li> </ul>	<b>3.00</b>
<b>2.5.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etem Iseni, Fekri Iseni, "THE IMPORTANCE OF FINANCIAL REPORTING AND AUDIT IN THE NEW SOCIO-ECONOMIC CIRCUMSTANCES", International Scientific Journal in economics, Finance, Business Marketing, Management and Tourism, Vol 3, No 5-6, Tetovo, 2016. ISSN (print) 1857-9566.</li> </ul>	<b>3.00</b>
<b>2.6.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etem Iseni, Fekri Iseni, " COST-BENEFIT ANALYSIS OF MIGRATION EFFECTS ON THE ECONOMY OF REPUBLIC OF MACEDONIA", 4th International Scientific Conference of the faculties of the economics &amp; Business Administration, University</li> </ul>	<b>3.00</b>

	of Tetovo, ISCFE, 2016, Tetovo. ISSN (print) 1857-9566	
<b>2.7.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etem Iseni, Sheherzada Murati, Fekri Iseni, “Tax Policy in small and medium sub-function funds”, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism, Vol.5 No 9-10, pp 37-43, Tetova, 2018. ISSN:2545-4544 (online)</li> </ul>	<b>3.00</b>
<b>2.8.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fekri Iseni, “Vendndodhja si faktorë i rritjes së ndërmarrjeve në Maqedoninë e Veriut”. Revista shqipëtare social ekonomike, Albanian socioeconomic review. Viti XXVII, nr.1 (104) Janar-Prill 2021. Online ISSN: 2312-5349.</li> </ul>	<b>5.00</b>
<b>2.9.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sali Zhaku, Arben Oda, Fekri Iseni, Sheherzada Murati, “Alternative energy as a need for a new world order” International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism (Economic Vision) Vol.9, No 17-18, Year 2022. ISSN (online): 2545-4544, ISSN (print) 1857-9566.</li> </ul>	<b>3.00</b>
<b>2.10</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arben Oda, Sali Zhaku, Fekri Iseni, “SWOT analysis in fuction of the development of hotel enterprises in Struga. Revista shqiptare social ekonomike – Albanian socio economic review, viti XXVII, nr.1 (107), Tiranë 2022, faqe 57-66. ISSN (print) 2222-5846, ISSN (online) 2312-5349.</li> </ul>	<b>3.00</b>
	<b>Gjithsej :</b>	<b>34</b>
<b>3.</b>	<b>Publikime tjera</b>	<b>Pikë</b>
<b>3.1</b>	Dr Etem Iseni&Dr Fekri Iseni ,Kontabilitet Financiar, Tetovë 2015	<b>6.00</b>
<b>3.2</b>	Dr Etem Iseni&Dr Fekri Iseni ,Plani kontabël analitik, Tetovë 2015	<b>6.00</b>
<b>3.3</b>	Dr Etem Iseni&Dr Fekri Iseni ,Bazat e kontabilitetit, Tetovë, 2017	<b>6.00</b>
	<b>Gjithsej :</b>	<b>18.00</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN</b>	<b>Pikë</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	<b>32.04</b>
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	<b>34.00</b>
VEPRIMTARIA PUBLIKUESE	<b>18.00</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>84.04</b>

Tetovë, Korrik 2022

**Anëtarët e Komisionit Recensues:**

- 1. Prof. Dr. Shiret Elezi-kryetar**  
Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

- 2. Doc. Dr. Sindis Salihi – anëtar**  
Profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

- 3. Doc. Dr. Teuta Qerimi- anëtar**  
Profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

Drejtuar:  
Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik  
pranë Universitetit të Tetovës

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRRJE TË TITULLUAR DOCENT NË LËMIN EKONOMIA REGJIONALE (50306 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTARË TË FRAKSATIT) NË FAKULTETIN EKONOMIK PRANË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më datë 20.Maj,.2022, në gazetën ditore "Koha" dhe "Nova Makedonija", dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 12.Qershor.2022, ka sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr. 14-379/6, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje "Docent i titulluar" në lëminë "**Ekonomia regjionale (50306)**" (komform klasifikimit të sferave, fushave dhe lëmejeve shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje:

1. Prof.Dr. Arijeta Amzai (kryetar)
2. Prof.Dr. Bardhyl Dauti (anëtar)
3. Doc.Dr. Eshija Sheabi (anëtar).

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat:

1. Dr. Arben Halili

Komisioni pasi që konstatoi se dosja e aplikimit përmban në tërësi dokumentacionin e rregullt të paraparë komform kërkesave të konkursit, paraqet këtë:



## RAPORT RECENSUES

Më datë 20.Maj.2022, në gazetata ditore "Koha" dhe "Nova Makedonija", dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, është shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje "Docent i titulluar" në lëminë "Ekonomia regjionale - 50306 (komform klasifikimit të sferave, fushave dhe lëmejve shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)).

Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatit Dr. Arben Halili komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë.

### Të dhëna biografike

Dr. Arben Halili është i lindur më 10.01.1982 në f. Shipkovicë të Tetovës. Shkollën fillore e kreu në Shipkovicë, ndërsa arsimin e mesëm e mbaroi në vitin 2001 në Gjimnazin "Kiril Pejçinoviç" në Tetovë, drejtimi I përgjithshëm. Në vitin 2005 në "Universitetin e Evropës juglindore" në Fakultetin e Administrimit të biznesit, drejtimi financë mbaroi studimet dhe fitoi titullin ekonomist i diplomuar. Në vitin 2011 mbaroi studimet postdiplomike në Fakultetin e Administrimit të biznesit pranë Universitetit të Evropës jug-lindore në Tetovë me tezën e magjistraturës: "Ndikimi I politikës fiskale në zhvillimin e sektorit të bujqësisë-aspektet krahasimore", me çka kandidati fitoi titullin shkencor Magjistër i shkencave ekonomike. Në qershor të vitit 2018 në institutin ekonomik, pranë universitetit "Shën Kirili dhe Metodi në Shkup" mbron me sukses temën e doktoraturës "Efektet fiskale të politikave bujqësore në Republikën e Maqedonisë" dhe fiton gradën shkencore Doktor I shkencave ekonomike. Në vitin 2020, pranë Universitetit për turizëm dhe menaxhment në Shkup, regjistron edhe magjistraturën e dytë, dhe është në përfundim të tezës së masterit në analizimin e shfrytëzimit efikas të financave publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kandidati Arben Halili, veprimtarinë e tij profesionale e ka filluar në vitin 2005 kur është punësuar si **Këshilltar local për biznes** pranë projektit suedes SFARM e të financuar nga Agjencioni suedez për ndihmë ndërkombëtare SIDA. Gjatë viteve 2007-2008 punon si Market **developer** për qumshtoren më të madhe në Maqedoni, Qumshtorja e Manastirit(BIMILK). Nga viti 2008 deri në vitin 2013 punësohet pranë Federatës së fermerëve të Maqedonisë, e të financuar nga SIDA si **menaxher projektsh**.

Në prill të vitit 2013 zgjidhet **Drejtor i Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore**, pozicion të cilin e ushtron deri në nëntor të vitit 2014.

Nga nëntori i vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2020 ushtron detyrën e **Drejtorit general** pranë kompanisë **Normak investment group (Zona e lirë ekonomike, industrial dhezhvillimore në Tetovë)**. Nga viti 2017 e deri më tani ushtron detyrën e **Drejtorit organizativ** pranë **Televizionit kombëtar Klan Macedonia**. Poashtu, nga viti 2015 e deri në vitin 2019 dhe nga viti 2019 e deri më sot, në dy mandate radhazi, zgjidhet **anëtarë i Këshillit drejtues të Odës ekonomike të Maqedonisë veri-perëndimore**.

Kandidati Arben Halili është duke ndjekë trainimin kualifikues për licencë pranë Komisionit të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut si **këshilltar finacues për fonde investicionale**, si edhe trainimin tjetër për **broker për sigurime**, kurse në të kaluarën ka ndjek një numër të konsiderueshëm trainimesh edhe atë:

- 1) **Contemporary project management course 17-21.06.2013**
- 2) **Corporate governance training Level 2-12 modules juni-july 2014**
- 3) **Management and operational series of courses of USAID's Hope Fellowship Program January-April 2009**
- 4) **Conflict analyses course-USIP 29.07.2008**
- 5) **International cooperation and sustainable development - University of Bologna 11.09.2010**
- 6) **International summer University Macedonia – 11-22 july 2005**
- 7) **Leadership and development youth 04.06.2005**
- 8) **Risitë në furnizimet publike -13.02.2014**
- 9) **Praktikant në Kuvendin e Maqedonisë- Tetor 2005- Maj 2006.**
- 10) **Project management for consulting October 2014**
- 11) **Regional IPARD Training 01-02.10.2009**
- 12) **Resurset natyrore potencial zhvillimi 11.12.2021**
- 13) **School of entrepreneurship-Leksand**
- 14) **Using local resources for sustainable Micro regional development in agrobusiness Decembet 2011**

Kandidati Arben Halili, përveç gjuhës angleze dhe maqedonase, njeh mirë edhe gjuhën franceze-Niveli B1 çertifikuar nga Ministria e arsimit në Francë, gjuhën gjermane niveli B1 çertifikuar nga qendra e gjuhëve Fluent dhe A1 çertifikuar nga Goethe institute në Shkup..

Dr.sc.Arben Halili nga viti akademik 2019/2022 deri më sot është i angazhuar si mësimdhënës me kontratë në vepër në Fakultetin ekonomik të Universitetit të Tetovës. Ka marrë pjesë në kongrese, konferenca, seminare vendase dhe ndërkombtare. Është njohës i mire i programeve kompjuterike, si: Microsoft Word, Microsoft Excel, Power Point, Microsoft project, etj.

## **Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore**

Veprimtaria mësimore e Dr. Arben Halilit mund të përshkruhet si e rëndësishme aktive dhe e suksesshme për periudhën kohore në të cilën ka qenë i angazhuar.

Në kuadër të veprimtarisë edukative-mësimore pranë Fakultetit ekonomik në Universitetin e Tetovës ka mbajtur ligjërata, ushtrime dhe konsultime me studentë në programet studimore:

Në programin studimor Ndërtimtari, kandidati ka realizuar lëndët:

- a) Bazat e ekonomisë në ndërtimtarë,
- b) Komunikimi në Biznes

Në programin studimor Informatikë, kandidati ka realizuar lëndët:

- a) Modelet biznesore në e-biznes,
- b) Sjellja organizative,

Në programin studimor Agrobiznes, kandidati ka realizuar lëndët:

- a) Ekonomia rurale,
- b) Sipërmarrësia në Agrobiznes,
- c) Ekonomia e agroturizmit

### **Veprimtaria shkencore-hulumtuese**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave ekonomike dhe agroturizmit. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencor të botuar në revista dhe gazeta prestigjioze, dhe me pjesëmarrje në tubime shkencore dhe konferenca

Punime të publikuara në konferenca dhe revista:

- Arben Halili, Mislim Zendeli. Apiturism as a new dimension for traveling in Shar Mountain- Fourth International Scientific Conference CHALLENGES OF TOURISM AND BUSINESS LOGISTICS IN THE 21ST CENTURY »SCTBL 2021« UDK 338.48-6:638.1(497.7:23), ISBN 978-608-244-824-4
- Arben Halili. Performanca ekonomike dhe zhvillimi rural( Gazeta Lajm)
- Arben Halili. Sistemi tatimor i Maqedonisë( Revista Valuta)
- Arben Halili. Zhvillimi i biznesit të vogël, shtyllë kryesore e ekonomisë vendore (Revista Valuta)
- Arben Halili.Prodhimi vendor vet[em brenda kufijve( Fakti)

### **Veprimtaria me interes më të gjerë**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati Dr. Arben Halili, veprimtarinë me interes më të gjerë e ka zhvilluar si vijon:

- Pjesëmarrëse në debatet e organizuara nga Fakulteti Ekonomik.
- Organizim të forumeve rionre në kuadër të projekteve ndërkombëtare,
- Udhëheqje dhe realizim të trainimeve për biznes plane dhe menaxhim të biznesit,
- Menaxhimi të konferencave,
- Udhëheqje të manifestimit "Top 100 kompanitë më të sukseshme në Maqedoni"
- Menaxhimi me resurset njerëzore - Qendra Fluent Tetovë

### **Përfundimi dhe propozimi**

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtarinë mësimore dhe arsimore, shkencore e hulumtuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Dr. Arben Halili** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsejtë 91,6 pikë nga referencat profesionale. Me këtë e ka plotësuar numrin e nevojshëm të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen **DOCENT I TITULLUAR**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni recensues konstaton se: **Dr. Arben Halili** posedon cilësi shkencore-profesionale bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës. Komisioni ka verifikuar se kandidati **Dr. Arben Halili i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen Docent i titulluar**.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimorë-Shkencorë të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, që kandidati **DR Arben Halili** të zgjidhet në thirrjen **DOCENT I TITULLUAR NË LËMIN EKONOMIA REGJIONALE - 50306**, në të gjitha programet studimore në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Tetovë, Gusht, 2022

Komisioni:

Prof.dr. Arijeta Amzai, Kryetar \_\_\_\_\_  
Prof.Dr. Bardhyl Dauti (anëtar) \_\_\_\_\_  
Doc.Dr. Eshija Sheabi (anëtar)

\_\_\_\_\_

## FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE - SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE - PROFESIONALE

Kandidati I (Kreu i parë): **Dr. Sc. Arben Halili**

Institucioni: **Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës**

**Lëmi shkencorë:** Ekonomia regjionale (50306 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

<b>Nr. Rendor</b>	<b>KUSHTET E PËRGJITHSHME</b>	<b>Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo</b>
<b>1.</b>	Nota mesatare të paktën 8.00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veç e veç, d.m.th. ka arritur një sukses mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) të studimeve të integruara të ciklit të parë dhe të dytë*	Po
<b>2.</b>	Grada shkencore - Doktor i Shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: Shkenca shoqërore(5) <u>Fusha: Shkenca ekonomia regjionale - 50306</u>	Po
<b>3.</b>	Të paktën katër punime shkencore** të publikuara në botim shkencor referues në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
<b>3.1</b>	Revistë shkencore e recensuar që është e indeksuar në të paktën një bazë të dhënash në internet, të tilla si Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago, Journal Rank ose një bazë tjetër të dhënash të revistave që do të ta përcaktojë Këshilli Kombëtar i Arsimit të Lartë  Emri i tubimit ndërkombëtar: Fourth International Scientific Conference CHALLENGES OF TOURISM AND BUSINESS LOGISTICS IN THE 21ST CENTURY »ISCTBL 2021« UDK 338.48-	Po

	6:638.1(497.7:23), ISBN 978-608-244-824-4  Emrat e shteteve: Maqedoni Titulli i punimit: Apiturism as a new dimension of travelling around Sharr mountain (2021)	
4.	Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, d.m.th. një shkollë e lartë profesionale e pavarur. Gjuha e huaj: Angleze, frenge, gjermane Emri i dokumentit: Certifikatë Publikuesi i dokumentit: Ministria e arsimit France, qendra Fluent, Goethe institut Data e lëshimit të dokumentit: 19.11.2018; 10.02.2022	Po
5.	<b>Ka aftësi për të kryer veprimtari të arsimit të lartë</b> 1. Emri i institucionit në të cilin janë fituar aftësitë për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë. <u>Universiteti i Tetovës</u>  2. Lloji i trajnimit / përvojës / arsimimit për përvetësimin e aftësive për të kryer veprimtari të arsimit të lartë <u>Mësimdhënie</u>  3. Periudha e përvetësimit të aftësive për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë <u>2019-2022</u>	Po

## FORMULARI 2

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE - SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE - PROFESIONALE

Kandidati I (Kreu i parë): **Dr. Sc. Arben Halili**

Institucioni: **Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës**

Lëmi shkencorë: **Ekonomia regjionale (50306 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).**

### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i Aktiviteti	Kalkulimi	Pikët
1.	<b>Leksione të realizuara në ciklin e parë</b>		<b>19.6</b>
1.1	Viti akademik 2019/2020 -Bazat e ekonomisë (2+2)	4x15x0,04=2,4	2,4
1.2	Viti akademik 2020/2021 -Komunikimi në biznes (2+2) - Bazat e ekonomisë në ndërtimtari (2+2) - Ekonomia rurale (2+2) - Sipërmarrësia në agrobiznes (2+2)	4x15x0,04=2,4 4x15x0,04=2,4 4x15x0,04=2,4 4x15x0,04=2,4	7,2
1.3	Viti akademik 2021/2022 - Modelet biznesore në e-biznes (2+2) - Sjellja organizative (2+2) - Ekonomia rurale (2+2) - Ekonomia e agroturizmit (2+2)	4x15x0,04=2,4 4x15x0,04=2,4 4x15x0,04=2,4 4x15x0,04=2,4	9,6

### VEPRIMTARIA SHKENCORE – HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
-----	--------------------	-------

<b>rendor:</b>		
<b>1.</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	
<b>1.1.</b>		
<b>1.2.</b>		
<b>2.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë të njohur shkencore/profesionale</b>	<b>Pikët</b>
<b>2.1.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arben Halili, Mislim Zendeli. Apiturism as a new dimension for traveling in Shar Mountain- Fourth International Scientific Conference CHALLENGES OF TOURISM AND BUSINESS LOGISTICS IN THE 21ST CENTURY »SCTBL 2021« UDK 338.48-6:638.1(497.7:23), ISBN 978-608-244-824-4</li> </ul>	5x90%=4.5
<b>2.2.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arben Halili. Performanca ekonomike dhe zhvillimi rural( Gazeta Lajm)</li> </ul>	6x100%=6
<b>2.3.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arben Halili. Sistemi tatimor i Maqedonisë (Revista Valuta)</li> </ul>	6x100%=6
<b>2.4.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arben Halili. Zhvillimi i biznesit të vogël, shtyllë kryesore e ekonomisë vendore( Revista Valuta)</li> </ul>	6x100%=6
<b>2.5.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arben Halili.Prodhimi vendor vetëm brenda kufijve( Fakti)</li> </ul>	6x100%=6
<b>3.</b>	<b>Pjesëmarrje në takime shkencore me referat – prezentim</b>	
<b>3.1.</b>	Arben Halili- Prezentim ne Panairi Nderkombetar te Tiranes, 22-26 nentor, 2014.	1
<b>3.2.</b>	Arben Halili - Diaspora invest -OEMVP, Tetovo 2014	1
<b>3.3.</b>	Arben Halili - VLERESIM I PRODHIM TË PRODUKTEVE TË DRURIT DHE MOBILJEVE NE RAJONIN E POLLOGUT. Shtator 2011	1
<b>4.</b>	<b>Mobilitete</b>	
<b>5.</b>	<b>Përgatitje për lëndë të reja cikli i parë i studimeve</b>	
<b>5.1.</b>	<b>Përgatitje për lëndë të reja - ligjerata</b>	
	<i>Ekonomia rurale</i>	1
	<i>Sipërmarrësia në agrobiznes</i>	1
	<i>Sjellja organizative</i>	1
<b>5.2.</b>	<b>Përgatitje për lëndë të reja – ushtrime</b>	
	- Ekonomia rurale - Bazat e sipërmarrësisë	15x0.5=7,5



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zonat rurale si faktorë të rritjes ekonomike</li> <li>- Bujqësi e qëndrueshme për ekonomi rurale të qëndrueshme</li> <li>- Ekonomia rurale në funksion të zhvillimit rural</li> <li>- Prespektiva europiane e ekonomisë rurale</li> <li>- Teoritë e zhvillimit rural</li> <li>- Tipet e ndryshme të bujqësisë dhe impakti i tyre në politikat e zhvillimit rural dhe ekonomisë rurale</li>   <li>- Hyrje në ekonomi</li> <li>-- Aftësia role dhe teknikat menaxhuese</li> <li>- Aktivitetet promotive në turizëm</li> <li>- Sistemet dhe stilet menaxhimit</li> <li>- Komunikimi në biznes</li> <li>- Menaxhimi i burimeve njerëzore</li> <li>- Marketingu i produkteve bujqësore</li> </ul>	
	<b>Gjithsej</b>	<b>42</b>

#### VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikët</b>
1.	Pjesëmarrëse në debatin shkencor të organizuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tetovës me temë: "Sfidat ekonomike në periudhën post pandemike", Qershor 2022.	1
2.	Online debatë; Ndikimi i pandemisë mbi ekonominë nacionale, maj 2020.	1
3.	Top 100 kompanitë më të suksesshme shqiptare	9*1=9
4.	Pjesëmarës në konferencën fuqizimi i të rinjëve në biznes (viti 2014- Oemvp-lpa projekt)	1
5.	Praktikant në Kuvendin e Maqedonisë (6 muaj)	6*1=6
6.	Contemporary project management course 17-21.06.2013	1
7.	Corporate governance training Level 2-12 modules juni-july 2014	1
8.	Management and operational series of courses of USAID's Hope Followship Program January-April 2009	1
9.	Internatinal cooperation and sustainable development - University of Bologna 11.09.2010	1
10.	International summer University Macedonia – 11-22 july 2005	1
11.	Leadership and development youth 04.06.2005	1
12.	Risite në furnizimet publike -13.02.2014	1

<b>13.</b>	Project management for consulting October 2014	<b>1</b>
<b>14.</b>	Regional IPARD Training 01-02.10.2009	<b>1</b>
<b>15.</b>	Resurset natyrore potencial zhvillimi 11.12.2021	<b>1</b>
<b>16.</b>	School of entrepreneurship-Leksand	<b>1</b>
<b>17.</b>	Using local resources for sustainable Micro regional development in agrobusiness Decembet 2011	<b>1</b>
	<b>GJTIHSEJ</b>	<b>30</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>PIKËT</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE</b>	<b>19,6</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE – HULUMTUESE</b>	<b>42</b>
<b>VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË</b>	<b>30</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>91.6</b>

Tetovë, Gusht, 2022

Komisioni:

Prof.dr. Arijeta Amzai, Kryetar \_\_\_\_\_

Prof.Dr. Bardhyl Dauti (anëtar) \_\_\_\_\_

Doc.Dr. Eshija Sheabi (anëtar) \_\_\_\_\_

**Deri te:**

## **KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT EKONOMIK**

### **RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES**

*Për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje të titulluar **DOCENT** në lëminë e Kontabilitetit (50328) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).*

Në bazë të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr.14-379/3 të datës 14.06.2022 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit Ekonomik në përbërje:

1. **Prof. Etem Iseni (kryetar)** - profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.
2. **Prof. Dr. Selvie Thaçi (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.
3. **Prof. Dr. Afrim Alili (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Në lidhje me konkursin e shpallur në faqen zyrtare të **Universitetit të Tetovës** ([www.unite.edu.mk/konkurse](http://www.unite.edu.mk/konkurse)) si dhe në gazetata ditore “**Koha**” dhe “**Nova Makedonija**” të datës 20.05.2022 për zgjedhjen e Një mësimdhënësi në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëminë e Kontabilitetit (50328) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), u paraqit kandidati **Dr. Garip Alimi** .

### **1. TË DHËNA BIOGRAFIKE TË KANDIDATIT**

Kandidati, **Dr. GARIP ALIMI** është i lindur më 26.12.1960 në f. Bogovinë, komuna e Bogovinës - Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut, me vendbanim në f. Bogovinë, Komuna e Bogovinës. Shkollën fillore e kreu në f. Bogovinë ndërsa shkollën e mesme ekonomike në Gostivar (drejtimi Kontabilitet -Financa). Studimet diplomike i mbaroi në Fakultetin Ekonomik drejtimi financa pranë Universitetit të Prishtinës, dhe mbron temën e diplomës me titull “**Sistemi Kibernetikë dhe Financa**” dhe fiton titullin *Ekonomist i diplomuar*.

Në vitin 1996 punësohet në Komunën e Bogovinës si shef i kontabilitetit dhe financave deri në vitin 1999, ku ka udhëhequr pozicione të rëndësishme si udhëheqës i financave dhe Buxhetit. Nga viti 2000 Kalon si udhëheqës i ndërmarjes private për financa në veprimtari ekonomiko-juridike, kontabilitet dhe konsultime ‘‘ DINOR Consalting’’ - Tetovë, bashkpuntor i shumë revistave siq; Economicus, Dituria Vizioni, pastaj antar dhe udhëheqës – Moderator në forumin buxhetor nga na e Agjencionit Zviceran. Në vitin 1999/00 ka regjistruarë studimet pas

diplomike ne Fakultetin Ekonomik Universiteti i Prishtinës dhe në vitin 2009 ka mbrojtur temën e Magjistraturës me titull “ *Ndikimi i sistemit tatimor dhe politikës fiskale në zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në rajonin e Tetovës*”

Në vitin 2010 Licensohet nga Ministria e drejtësis si vlersuse i fushës financiare dhe materiale dhe bashkëpunor i biros per ekspertiz shtetërore të RMV.

Me dat 30.12.2011 regjistrohet ne fakultetin ekonomik Shën Kiril i Metodij dhe në vitin akademik 2018, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Kiril i Metodij” në Shkup mbron me sukses disertacionin e doktoraturës me titull “*Ndikimi i politikës Fiskale ndaj zhvillimit të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme –Rasti i Republikës së Maqedonisë* dhe merr titullin Doktor i Shkencave të Ekonomis shkurtimisht D-R apo PhD

Disertacioni i doktoratës ka dhënë kontribut të veçantë shkencor në lëmin e Kontabilitetit financiarë dhe Menaxherial për eliminimin e dobësive të kontimit duke u bazuar në Standardet e kontabilitetit Ndërkombëtarë, si dhe eliminimin e metodave klasike të prodhimit dhe përdorimi i metodave më të klasifikuara. Në lëmin e financave Publike dhe financave në sektorin privat i është dhënë rëndësi ndikimit të politikës fiskale (Qeveritare) ndaj zhvillimit të bizneseve të vogla dhe të mesme sidomos në ndarjen e subvencioneve dhe grandeve nga ana shtetore dhe shfritzimi i tyre i drejt nga ndërmarjet private. Gjithashtu kontribut i veçant në këte lami i ashtë dedikuar grumbullimit dhe shpërndarjes së Tatime, investimeve në infrastruktur si në sektorin Publik ashtu edhe në ate privat duke analizuarë dhe krahasuarë tatimet në të ardhura, tatimet në konsum dhe taimin në pronë pa hequr dorë në llogaritjen dhe alternativën e pagim - kthimit të TVSH-së dhe Akcizës dhe kjo i jep punimit të doktoratës origjinalitet si në aspektin shkencor ashtu edhe në atë aplikativ.

Prej vitit akademik 2019/2022 është angazhuar në Universitetin e Tetovës si ligjërues (part-time) në programin studimor Biznes Ndekombëtar dhe Kontabilitet -Financa pranë Fakultetit Ekonomik ne Universitetin e Tetovës.

## **2. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE – ARSIMORE**

### **Mbajtja e mësimit (ushtrime dhe ligjërata)**

Kandidati **Dr. Sc. Garip Alimi** ka mbajtur mësime (**ligjërata**, nën mentorim) në lëndët në vijim:

- **Fakulteti Ekonomik** - programi studimor **Biznes Ndërkombëtar**
  - Standardet Nderkombëtare të Kontabilitetit (SNK)
  - Kontabiliteti financiar
  
- **Fakulteti Ekonomik** - programi studimor **Financa Kontabilitet**
  - Praktik Profesionale Kontabilitet Financa

Kandidati, **Dr. Sc. Garip Alimi** ka mbajtur **Ushtrime**, në lëndët në vijim:

- **Fakulteti Ekonomik** - programi studimor **Biznes Ndërkombëtar**
  - Standardet Nderkombëtare të Kontabilitetit (SNK)
  - Kontabiliteti financiar
  
- **Fakulteti Ekonomik** - programi studimor **Financa Kontabilitet**
  - Praktikë Profesionale Kontabilitet financa
  - Financa Publike
  - Hyrje në Financa

### **3. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË SHKENCORE-HULUMTUESE**

Krahas angazhimit në fushën e udhëheqjes të kontabilitetit të më shumë kompanive private dhe në procesin mësimor, kandidati është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore në larin e financave Publike në temën “*karakteristikat e Taksave, politikës fiskale dhe Monetare*” dhe angazhimi në sektorin privat ku janë bërë shumë analiza krahasuese në lidhje me pagesat e Tatimeve, TVSH-së në Kontabilitet nga ana e bizneseve private, çështja e punësimit në sektorin privat dhe evidenca kontabël e stimulimeve nëpër mjet grandeve dhe subvencioneve nga ana Qeveris. *Rëndësi të veçantë i ashtë kushtuar rrolit të të ardhurave nga tatimet* dhe regjistrimi i tyre në Kontabilitet në aktivitetin real ekonomik të një shteti dhe *ndikimi i remetencave në ekonomi dhe Buxhet – rasti i Maqedonisë Veriore* si një fushë shumë diskutabile në ngritjen e GDP-së Në vitin që lamë pas ose në kohën e Pandemisë nga ana e kandidatit është *Analizuar me metodën krahasuese ndikimi i Investimeve Publike si faktorë në rritjen e zhvillimit ekonomik* sidomos në sektorin privat dhe Publik, si dhe pasqyra e kontabilitetit në uljen e shpenzimeve dhe në ngritjen e Pagave. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikujt shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe me pjesëmarrje në tubime shkencore në vend dhe jashtë tij. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur më poshtë:

1. **Dr Garip Alimi**, *CHARACTERISTIK OF THE TAX AND MONETARY POLICY OF EU COUNTRIES THE IMPACT ON SMALL AND MEDIUM BUSINES (SMEs)*
  
2. **Dr. Garip Alimi**, *THE ROLE OF PUBLICREVENUS FROM TAXES AND REVENUS IN THE REAL ECONOMIC ACTYVVITYOF A CONTRY ,THE STATE*
  
3. **Dr.Garip Alimi**, *THE IMPACT OF REMITANCES ON ECONOMIK GROWT-NORTH MACEDONIAN CASE*
  
4. **Dr. Garip Alimi**, *IMPACT OF PUBLIC INVESTIMENT ON ECONOMIK GRWTH NORTHERN MACEDONIA*
  
- 5.

#### 4. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

##### Pjesëmarrje në aktivitet promotive të fakultetit

Kandidati **Dr. Garip Alimi** ka marrë pjesë në aktivitetet promotive “USHT – Ditët e hapura pranë Fakulteti Ekonomik (UT).

#### 5. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Si shtojcë e referatit është bashkangjitur raporti i zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati **Dr. Sc. Garip Alimi** ka gjithsej 63.4 pikë, edhe atë për: Veprimtarinë mësimore-arsimore 27.4 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 20 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative 3 pikë dhe veprimtaritë me interes më të gjerë 13 pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	27.4
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	12
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	22
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJËRË	16
<b>Gjithsej</b>	<b>77.4</b>

#### PROPOZIM - VENDIM

Në bazë të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe kushteve të kërkuara për zgjedhje- rizgjedhje në thirrje mësimore - shkencore në Fakultetin Ekonomik – Universiteti i Tetovës, Komisioni Recensus ka nderin dhe kënaqësinë e veçantë t’i propozojë Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik që:

Kandidati **Dr. Sc. Garip Alimi** të zgjidhet në thirrjen mësimore - shkencore **DOCENT i titulluar** në lëmin e Kontabilitetit (50328) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë \_\_\_\_\_ 2022

#### Anëtarët e Komisionit Recensus:

- 1. Prof. Dr. Etem ISENI - kryetar**  
Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës
- 2. Prof. Dr. Selvije THAÇI – anëtar**  
Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

**3. Prof. Dr. Afrim ALILI - anëtar**

Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

## FORMULARI 1

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: **Dr. Sc. Garip Alimi**

Institucioni: **Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës**

Lëmi shkencore: **Kontabiliteti (50328)**nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1.	Nota mesatare të paktën 8.00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veç e veç, d.m.th. ka arritur një sukses mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) të studimeve të integruara të ciklit të parë dhe të dytë * Nota mesatare në ciklin e parë të studimeve: <b>7.00</b> Nota mesatare në ciklin e dytë të studimeve: <b>8.0</b> Nota mesatare në studimet e doktoraturës ( <i>Sistemi i vjetër me mbrojtje</i> )	-
2.	Grada shkencore - Doktor i Shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet <b>Doktor i shkencave Ekonomike</b> <b>Kontabilitet Financa</b>	Po
3.	Të paktën katër punime shkencoretë publikuara në botim shkencor referues në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje. (Shih listën e punimeve shkencore në raport)	Po
4.	Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, d.m.th. një shkollë e lartë profesionale e pavarur. Gjuha e huaj: <u>Gjermane</u> Emri i dokumentit: <u>Vërtetim</u> Publikuesi i dokumentit: <u>Qendra për gjuhë të huaja Deutsch</u> Data e lëshimit të dokumentit: <u>19.06.2003</u>	Po



5.	<p><b>Ka aftësi për të kryer veprimtari të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit në të cilin janë fituar aftësitë për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë. <i>Universiteti i Tetovës</i></p> <p>2. Lloji i trajnimit / përvojës / arsimimit për përvetësimin e aftësive për të kryer veprimtari të arsimit të lartë <i>Mësimdhënie</i></p> <p>3. Periudha e përvetësimit të aftësive për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë <i>2019-2022</i></p>	Po

## FORMULARI 2

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati I (Kreu i parë): **Dr. Sc. Garip Alimi**

Institucioni: **Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës**

Lëmi shkencore: **Kontabiliteti** (50328 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

#### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikë
<b>1.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave me mbulesë nga profesori bartës i lëndës, në ciklin e parë të studimeve</b>	
1.1.	Standardet nderkombtare te kontabilitetit (SNK) 2x15x0,04x6	7,2
1.2.	Praktikë Profesionale kontabilitet Financa 2x15x0,04x6	7.2
<b>2.</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve me studentë</b>	
2.1.	Standardet Ndërkombtare tëKontabilitetit ( SNK) 2x15x0,03x6	5.4
2.2.	Praktikë Profesionale kontabilitet Financa	

	- Financa Publike - 2x15x0,03x4 - Hyrje ne Financa - 2x15x0,03x4	3.6  3.6
<b>3.</b>	<b>Konsultime me studentë</b>	
<b>3.1.</b>	Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK 100x0,002 Praktik profesionale Kontabilitet financa 100x0,002	0,2  0,2
<b>4.</b>	<b>Përgatitja e lëndës së re</b>	
<b>4.1.</b>	<b>Ligjërata</b>	
<b>4.1.1.</b>	Standardet Ndërkombtare të Kontabilitetit SNK	
<b>4.1.2.</b>	Praktik Profesionale Kontabilitet Financa	
<b>4.2.</b>	<b>Ushtrime</b>	
<b>4.2.1.</b>	Standardet Ndërkombtare të Kontabilitetit SNK	
<b>4.2.2.</b>	Praktik Profesionale Kontabilitet Financa	
	<b>Gjithsej</b>	<b>27.4</b>

## VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

<b>N. R.</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikë</b>
<b>1.</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	
<b>1.1.</b>	Teza e doktoratës mban titullin “ <i>Ndikimi i politikës Fiskale ndaj zhvillimit të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme – Rasti i Republikës së Maqedonisë</i> ” mbrojtur në vitin <b>2018</b> .	
<b>2.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar</b>	<b>Pikë</b>
<b>2.1.</b>	<b>Garip Alimi</b> , GSJ: Volume 10, Issue 1, January 2022, Online: ISSN 2320-9186 www.globalscientificjournal.com CHARACTERISTICS OF THE TAX AND MONETARY POLICY OF EU COUNTRIES AND THE IMPACT ON SMALL AND MEDIUM BUSINESSES (SMEs)	<b>3</b>
<b>2.2.</b>	<b>Garip Alimi</b> , Published in Volume 10 Issue 5, May 2022 THE ROLE OF PUBLIC REVENUES FROM TAXES AND OTHER REVENUES IN THE REAL ECONOMIC ACTIVITY OF A COUNTRY, THE STATE	<b>3</b>
<b>2.3.</b>	<b>Garip Alimi</b> , GSJ: Volume 10, Issue 5, May 2022, Online: ISSN 2320-9186 www.globalscientificjournal.com THE IMPACT OF REMITTANCES ON ECONOMIC GROWTH- NORTH	<b>3</b>

	MACEDONIAN CASE	
2.4.	<b>Garip Alimi</b> , GSJ: Volume 10, Issue 5, May 2022, Online: ISSN 2320-9186 www.globalscientificjournal.com IMPACT OF PUBLIC INVESTMENT ON ECONOMIC GROWTH IN NORTHERN MACEDONIA	3
	<b>Gjithsej</b>	12

### VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikë
<b>1.</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitete promotive të fakultetit/institutit</b>	
1.1.	“UT – Ditët e hapura 2020 - Promovimi i programit studimor Standardet Nderkombtare te Kontabilitetit – Fakulteti Ekonomik (UT)“	1
1.2.	UT – Ditët e hapura 2021 - Promovimi i programit studimor Kontabilitet financiare – Fakulteti Ekonomik (UT)“	1
1.3.	“UT – Ditët e hapura 2022 - Promovimi i programit studimor Praktik Profesionale kontabilitet financa – Fakulteti Ekonomik (UT)“	1
1.4	<b>Dr.Garip Alimi</b> Praktikum (në form skripti) material i mledhur nga SNK për student, <i>Lënda Standardet Nderkombtare të Kontabilitetit</i>	3
1.5	<b>Dr.Garip Alimi</b> Broshur ,material i pergaditur per student nga Lënda; <i>Kontabiliteti Financiar</i>	3
1.6	<b>Dr.Garip Alimi</b> Praktikum,material i prëgaditur me shkrim dhe sllajde per Sudentet në Lëndën “ <i>Praktik Profesionale dhe Financa</i> ”	3
1.7	<b>Dr.Garip Alimi</b> Material i pergaditur per botim jashta vendit me titull “ <i>Stimulimi dhe Grandet nga Qeveria e RMV, për ndermarjet e vogla dhe te mesme</i> “	3
1.8	<b>Dr.Garip Alimi</b> ‘ <i>Reformat e Tatimeve –Tatimi Progresiv në R,M Veriore</i> ’ <i>Punim shkencor.Tetovë 2014</i>	1
1.9	<b>Dr. Garip Alimi</b> “ <i>Analiza e performacës financiare te kompanit e vogla dhe te . mesme rajoni i iTetoves</i> ” <i>Punim shkencor.Tetovë 2015</i>	1
2.0	Dr. Garip Alimi“ <i>Vlersimet dhe Rivlersimet Doganore gjat vlersimit të TVSH-së dhe Akcizes</i> ” <i>Punim seminarik Prishtin 2009.v</i>	1
2.1	<b>Garip Alimi</b> ‘ <i> Makro ekonomia dhe politika fiskale “ Unilogos Shkup 2011</i>	1
2.2	<b>Garip Alimi</b> “Menaxhimi i sektorit fiskal ne ekonomit në tranzicion” <i>Klubi Demokratik Shkup 2013</i>	1
2.3	<b>Garip Alimi</b> “Analiza e tregut dhe Konsumatori” <i>Unilogos Shkup 2015</i>	1
2.4	<b>Garip Alimi</b> “Qeverisja e reformave në sistemin financiar” <i>Dituria Gostivar 2015</i>	1
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>22</b>

### VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

N. R.	Emri i aktivitetit:	Pikë
1.	Qëndrim studiuës në institucione tjera	

<b>1.1.</b>	Këshilltar i financave në Komunën e Bogovinës 1997-1999	<b>3</b>
<b>1.2.</b>	Udhëheqës i Buxhetit dhe Financave në Komunën e Bogovinës 1999-2000	<b>4</b>
<b>1.3.</b>	Bashkëpunëtor i shumë revistave: Economicus, Dituria, Vizioni, Seeu-review dhe revista tjera ekonomike.	<b>2</b>
<b>1.4.</b>	<b>Këshilltare</b> i financave dhe Buxhetit ne NKP SHARRI Kom.e Bogovines 2019-2022	<b>3</b>
<b>1.5.</b>	- Anëtar i grupës operative Forumi i agjencionit të Komunitetit Zvicerian 2010	<b>2</b>
<b>1.6.</b>	-Ko-moderator në Forumin Buxhetor nga ana e Agjencionit Zvicerian 2011.	<b>2</b>
	<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN</b>	<b>Pikë</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	<b>27.4</b>
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	<b>12</b>
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	<b>22</b>
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	<b>16</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>77.4</b>

Tetovë, Qershor 2022

#### **Anëtarët e Komisionit Recensues:**

**1. Prof. Dr. Etem ISENI -kryetar**

Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

**2. Prof. Dr. Selvije THAÇI – anëtar**

Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

**3. Prof. Dr. Afrim ALILI - anëtar**

Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

Drejtuar:  
Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik  
pranë Universitetit të Tetovës

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË  
MËSIMDHËNËSI NË THIRRJE TË TITULLUAR DOCENT NË LËMIN VENDIMMARRJE (50614  
NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË HULUMTUES  
SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTARË TË FRAKSATIT)  
NË FAKULTETIN EKONOMIK PRANË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më datë 20.Maj,2022, në gazetat ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija”, dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 12.Qershor.2022, ka sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr. 14-379/5, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje “Docent i titulluar” në lëminë “Vendimarrje - 50614 (komform klasifikimit të sferave, fushave dhe lëmejeve shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje:

1. Prof.dr. Brikend Aziri, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.
2. Prof.dr. Besa Xhaferi, Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.
3. Prof.dr. Aida Yzeiri Baftijari, Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat:

1. Dr. Arbresha Ajdini Durmishi

Komisioni pasi që konstatoi se dosja e aplikimit përmban në tërësi dokumentacionin e rregullt të paraparë komfor kërkesave të konkursit, paraqet këtë:

## **RAPORT RECENSUES**

Më datë 20.Maj.2022, në gazetata ditore "Koha" dhe "Nova Makedonija", dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, është shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimsdhënësi në thirrje "Docent i titulluar" në lëminë "Vendimtarje - 50614 (komform klasifikimit të sferave, fushave dhe lëmejve shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)).

Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatit Dr. Arbresha Ajdini Durmishi komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë.

### **Të dhëna biografike**

Arbresha Ajdini Durmishi ka lindur në Shkup në Dhjetor të vitit 1986. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin "Pançe Popovski" në Gostivar. Në vitin 2005 regjistrohet në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ku diplomoi në drejtimin Administrim Biznesi dhe në vitin 2008 fiton titullin e diplomuar në Administrim Biznesi. Në të njëjtin vit regjistrohet në studimet Master po në të njëjtin drejtim – Administrim Biznesi - Menaxhment. Në vitin 2012 e mbrojti temën e magjistraturës me titull "Etika në biznes – me theks të veçantë në kompanitë e regjionit të Pollogut", dhe fitoi titullin Magjistër i Administrim Biznesit – Menaxhment. Në vitin 2013 regjistrohet në studimet e doktoratës në Institutin për studime ekonomike pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në drejtimin Shkenca organizative dhe të udhëheqjes (Menaxhment). Në Qershor të vitit 2020 përfundon studimet e ciklit të tretë duke mbrojtur me sukses temën e doktoratës në titull "Roli dhe rëndësia e lidershit në përmirësimin e performancës së punëtorëve në kompanitë e regjionit të Pollogut" dhe fitoi titullin "Doktor i shkencave organizative dhe të udhëheqjes – Menaxhment".

Arbresha Ajdini Durmishi nga muaji Maj / 2007 deri në Nëntor / 2010 ka punuar si menaxhere në biznesin familjar. Që nga Dhjetori i vitit 2010 është e punësuar në Departamentin për financa dhe kontabilitet në Universitetin e Tetovës. Ajo ndër vite ka qenë e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit për një varg të lëndëve nga lëmia e menaxhmentit dhe marketingut në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Nga dokumentacioni në disponim, komisioni ka konkluduar që Arbresha Ajdini Durmishi pos gjuhëve lokale zoton në nivel të shkëlqyer edhe gjuhën angleze. Ajo në cilësinë e bashkëpunëtorit në Fakultetin Ekonomik ka manifestuar kapacitete akademike, hulumtuese dhe komunikative të një niveli të lartë.

## **Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore**

Veprimtaria mësimore e Dr. Arbresha Ajdini Durmishi mund të përshkruhet si adekuate, aktive dhe e suksesshme. Ajo ka qenë ndër vite e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit në një varg të lëndëve në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tetovës dhe Fakultetin e Shkencave të Zbatuara pranë Universitetit të Tetovës. Kështu në programin studimor "Marketing dhe menaxhment" në Fakultetin Ekonomik kandidatja ka realizuar lëndët: Menaxhimi strategjik, Parimet e marketingut, Menaxhimi i burimeve njerëzore, Marketing menaxhment, Bazat e menaxhmentit, Marketing dhe politika e çmimeve, Menaxhment ndërkombëtar, Marketingu ndërkombëtar, Etika në administratën shtetërore.

Në programin studimor "Financa dhe kontabilitet" në Fakultetin Ekonomik kandidatja ka realizuar lëndët: Hyrje në ekonomi, Menaxhimi i burimeve njerëzore, Menaxhmenti ndërkombëtar.

Në programin studimor "Biznes ndërkombëtar" në Fakultetin Ekonomik kandidatja ka realizuar lëndët: Konceptet e menaxhmentit, Menaxhimi strategjik, Marketingu ndërkombëtar.

Në programin studimor "Ekonomi dhe biznes" në Fakultetin Ekonomik kandidatja ka realizuar lëndët: Menaxhimi i burimeve njerëzore, Menaxhimi strategjik, Marketingu ndërkombëtar.

Në programin studimor "Turizëm" në Fakultetin Ekonomik kandidatja ka realizuar lëndën Aktivitete promotive në Turizëm. Ndërkaq në programin studimor "Gazetari dhe shkenca politike" në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tetovës ka realizuar lëndën Hyrje në ekonomi dhe në programin studimor "Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë" në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara pranë Universitetit të Tetovës ka realizuar lëndën Menaxhimi i punëve gjeodezike".

## **Veprimtaria shkencore-hulumtuese**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore në lëmin e ekonomisë dhe më gjerë. Veprimtaria shkencore - hulumtuese përbëhet nga artikujt shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe me pjesëmarrje në tubime shkencore ndërkombëtare, të listuara më poshtë:

Punime të publikuara në konferenca dhe revista shkencore ndërkombëtare:

- Arbresha Ajdini Durmishi. Business ethics-with special emphasis on Polog region companies. ECONOMIC VISION 3-4 b Vol. 2 UDC:33 ISSN 1857-9566 2015
- Arbresha Ajdini Durmishi & Adrian Durmishi. Business ethics and the law. JUSTICIA 7/2017 Vol. 5 UDC: 34 No. 7 ISSN 1857-8454 (print) 2017
- Arbresha Ajdini Durmishi dhe të tjerë. Major ethical challenges that many organizations face today. ECONOMIC VISION 9-10 Vol. 5 UDC:33 ISSN: 1857-9566

- (print) ISSN: 2545-4544 (online). 2018
- Arbresha Ajdini Durmishi. Business ethics -necessity or luxury. REVISTA VIZIONE 29/2018 UDC: 334.72 : 174 (497.75). 2018
  - Arbresha Ajdini Durmishi. Comparative analysis of contemporary management practices in small and medium enterprises. REVISTA VIZIONE 29/2018 UDC: 334. 72.012 631. 64 : 005. 332.1/: 303.446 (497.75). 2018
  - Arbresha Ajdini Durmishi & Vasil Popovski. The relationship between effective leadership and the performance of employees. ECONOMIC DEVELOPMENT. Journal of The Institute of Economics – Skopje, Year.22 No. 1-2/2020, June 2020

Trajnime të mbajtura jashtë vendit me ftesë të universitetit  
ERASMUS+ Staff Mobility for training. Yildiz Teknik Universitesi. Stamboll - Turqi. Dhjetor 2018.

### **Veprimtaria me interes më të gjerë**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Dr. Sc. Arbresha Ajdini Durmishi, veprimtarinë me interes më të gjerë e ka zhvilluar si vijon:

- Pjesëmarrëse në aktivitetet: ditët e hapura të Universitetit të Tetovës.
- Pjesëmarrëse në debatet e organizuara nga Fakulteti Ekonomik.

### **Përfundimi dhe propozimi**

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtarinë mësimore dhe arsimore, shkencore e hulumtuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Dr. Arbresha Ajdini Durmishi** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsejtë 99.352 pikë nga referencat profesionale. Me këtë e ka plotësuar numrin e nevojshëm të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen **DOCENT I TITULLUAR**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni recensues konstaton se: **DR. ARBRESHA AJDINI DURMISHI** posedon cilësi shkencore-profesionale bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës. Komisioni ka verifikuar se kandidati **Dr. Arbresha Durmishi Ajdini i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen Docent i titulluar**.



Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimorë-Shkencorë të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, që kandidati **DR ARBRESHA AJDINI DURMISHI** të zgjidhet në thirrjen **DOCENT I TITULLUAR NË LËMIN VENDIMMARRJE - 50614**, në të gjitha programet studimore në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Tetovë, Gusht, 2022

Komisioni:

Prof.dr. Brikend Aziri, Kryetar

---

Prof.dr. Besa Xhaferi, Anëtar

---

Prof.dr. Aida yzeiri Baftijari, Anëtar

---

## FORMULARI 1

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE - SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE - PROFESIONALE

Kandidati I (Kreu i parë): **Dr. Sc. Arbresha Ajdini Durmishi**

Institucioni: **Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës**

**Lëmi shkencorë:** Vendimmarje (50614 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1.	Nota mesatare të paktën 8.00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veç e veç, d.m.th. ka arritur një sukses mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) të studimeve të integruara të ciklit të parë dhe të dytë* Nota mesatare në ciklin e parë të studimeve: 8.6 Nota mesatare në ciklin e dytë të studimeve: 8.6 Nota mesatare në studimet e integruara: 8.6	Po
2.	Grada shkencore - Doktor i Shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: <u>Shkenca organizative dhe të udhëheqjes (Menaxhment) - 506</u> Lëmia: Vendimmarje (50614)	Po
3.	Të paktën katër punime shkencore** të publikuara në botim shkencor referues në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
3.1	Revistë shkencore e recensuar që është e indeksuar në të paktën një bazë të dhënash në internet, të tilla si Ebsco, Emerald, Scopus, Eëb of Science, Journal Citation Report, SCImago, Journal Rank ose një bazë tjetër të dhënash të revistave që do të ta përcaktojë Këshilli Kombëtar i Arsimit të Lartë  1. Emri i revistës shkencore: Economic Development 2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: Ebsco 3.Emri i punimit: The relationship between effective leadership and the performance of employees 4. Data e publikimit: 2020 UDC 005.322:316.46]:005.6(497.75) Economic Development No. 1-2/2020 p. (119-132)	Po

<p><b>3.2.</b></p>	<p>Një revistë shkencore në të cilën punimet e botuara janë të recensuara dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende, dhe numri i anëtarëve nga një vend nuk mund të kalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: International magazine for social sciences "VIZIONE " Skopje  2. Bordi Redaktues Ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendit): 16 anëtarë, 7 vende: Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, Kanadë, Bullgaria, Irlanda Veriore, Turqi.  3. Emri i punimit: Comparative analysis of contemporary management practices in small and medium enterprises (case study - Polog region)  4. Data e publikimit: 2018  ISSN: 1409-8962- printed form  ISSN 1857- 9221- electronic form</p>	<p>Po</p>
<p><b>3.3.</b></p>	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet e publikuara janë të recensuara dhe që publikohet në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe/ose OBZhE.</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: International magazine for social sciences "VIZIONE " Skopje  2. Emri i anëtarit të BE/OBZhE: Dr Antoneta Vassileva  3. Emri i punimit: Business ethics - necessity or luxury  4. Data e publikimit: 2018  ISSN: 1409-8962- printed form  ISSN 1857- 9221- electronic form</p>	<p>Po</p>
<p><b>3.4.</b></p>	<p>Përmbledhje e punimeve shkencore të recensuara, të prezentuara në konferenca akademike ndërkombëtare ku anëtarët e bordit shkencor janë nga të paktën tre vende.</p> <p>1. Emri i përmbledhjes: Economic Vision  2. Emri i konferencës ndërkombëtare: Economic development as a precondition for EU integration  3. Emrat e vendeve: Anglia, Shtete e Bashkuara të Amerikës, Suedia, India, Malajzia, Turqia, Bullgaria, Slovakia, Shqipëria, Kroaci, Kosovë, Maqedonia, Portugalia, Italia.  4. Emri i punimit: Major ethical challenges that many organizations face today.  5. Data e publikimit: 2018  ISSN: 1857 – 9566 (Print)  ISSN: 2545 – 4544 (Online)  UDC:334.72:174:303.62(497.75)</p>	<p>Po</p>

<p><b>4.</b></p>	<p>Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, d.m.th. një shkollë e lartë profesionale e pavarur.  Gjuha e huaj: Angleze  Emri i dokumentit: Certifikatë  Publikuesi i dokumentit: SEEU  Data e lëshimit të dokumentit: 26.05.2022</p>	<p>Po</p>
